



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 1157/1 Prot.

Tiranë, më 21.4.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj me *e-mail*, të datës 23 mars 2022

Z. G A , GAZETAR  
EMISIONI "STOP" PRANË KLAN TV

I nderuar zoti A

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, dërguar në *e-mail*-in zyrtar të Koordinatorit për Median të KPK-së, më datë 23 mars 2022, dhe protokolluar me tonën nr. 1157 prot., datë 24.3.2022, ju informojmë se:

- 1- Lidhur me pyetjen e parë, siç sqarohet edhe përmes njoftimit zyrtar në faqen e internetit *kpk.al*, të datës 23.3.2022, seanca e datës 25 mars 2022 u anulua, për shkak se është riçelur hetimi kryesisht për vlerësimin pasuror, si edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit.
- 2- Sa i takon pyetjes së dytë, e cila ka të bëjë me vetë themelin e çështjes së rivlerësimit për subjektin E. K sqarojmë se Komisioni nuk është shprehur ende me vendim përfundimtar. Për sa kohë me vendim të ndërmjetëm trupi gjykues ka vendosur riçeljen e hetimit kryesisht, çështja konsiderohet ende nën hetim dhe për pasojë, nuk mund të jepen informacione shtesë që cenojnë sekretin hetimor të çështjes.
- 3- Lidhur me sa kërkoni në pyetjen tuaj të tretë, bashkëngjitur ju vëmë në dispozicion procesverbalin e transkriptuar të seancës dëgjimore.
- 4- Në vijim të përgjigjes për pyetjen e tretë, ju mund të informoheni lidhur edhe me pyetjen tuaj të katërt, përmes procesrvebalit të seancës dëgjimore publike të datës 17.3.2022, të zhvilluar nga Komisioni me këtë subjekt rivlerësimi.
- 5- Lidhur me pyetjen tuaj të pestë, ju informojmë se bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues, në çdo fazë të procesit të rivlerësimit, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar, shprehet me vendim të ndërmjetëm për çdo pyetje apo kërkesë procedurale të parashtruar nga subjekti i rivlerësimit.  
Trupi gjykues, pasi vlerëson shpjegimet dhe aktet e administruara gjatë hetimit, si dhe ato në seancë dëgjimore, ka të drejtë të riçelë hetimin kryesisht.
- 6- Lidhur me pyetjen tuaj të fundit, ju informojmë se anëtarët e trupit gjykues në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe vetë subjekti i rivlerësimit, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore në fuqi kanë deklaruar dhe nënshkruar mungesën e konfliktit të interesit për rastin konkret.

Duke ju falënderuar për sa më sipër,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

